



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (KGj), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2025 shpenzime në vlerë 2,700,991€, ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate.
- A1 Në dy mostra të testuara kemi identifikuar se komuna kishte bërë nënvlerësim të detyrimeve kontingjente në vlerë prej 355,000€. Ndërsa nga 99 raste të padive për shpronësim vetëm një rast në vlerë prej 29,577€ ishte prezantuar në shpalosjet e PFV-ve.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardevë, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjakovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- B2 Nga testimi i pesë mostrave në vlerë totale prej 252,903€, kemi vërejtur se obligimet e papaguara nuk ishin shlyer brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 73 deri 284 ditë kalendarike.
- A2 Në dy raste Komuna kishte lidhur kontratë pa u përmbushur kërkesat e dosjeve të tenderit.
- A3 Pagesa e subvencionit është ekzekutuar në një llogari bankare të ndryshme nga ajo e përcaktuar në kontratë, duke mos respektuar dispozitat kontraktuale që kërkojnë transferimin e mjeteve në llogarinë zyrtare të përfituesit.
- A4 Në dy raste në vlerë prej 225,000€, Komuna ka ekzekutuar subvencione pa lidhur paraprakisht kontrata/marrëveshje me përfituesit e subvencioneve.
- A5 Komuna kishte lidhur kontratë në vlerë prej 206,514€, edhe pse vlera e parashikuar e kontratës dhe fondet e aprovuara në Deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve ishin vetëm 162,554€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të cilat kanë përmbajtur gabime në prezantimin dhe shpalosjen e informatave. Pas kërkesës tonë disa çështje të ngritura në PFV-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF.

Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e të hyrave, llogarive të arkëtushme, klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale, si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur më poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja, pesë të përsëritura dhe një pjesërisht e përsëritur.

Nga të dhënat e komunës kemi vërejtur se si rezultat i kontratës kolektive, Thesari kishte realizuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2025 në vlerë 2,700,991€ për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuatë.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 thekson se ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Gjithashtu sipas Qarkores Buxhetore me numër 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat thekson se në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet i marrin brenda kufijve të ndare buxhete për komunat me këtë qarkore duke përjashtuar nga kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa. Poashtu, sipas Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, "Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël". Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Gjatë vitit 2025, përmes Thesarit, bazuar në vendime gjyqësore dhe përmbartimore lidhur me pagat jubilarë dhe shujtat, janë ekzekutuar pagesa në vlerë totale prej 2,700,991€. Nga kjo shumë, 2,474,282€ janë ekzekutuar nga kategoria Investime kapitale, ndërsa 226,708€ nga

kategoria mallra dhe shërbime, ndonëse këto pagesa, për nga natyra ekonomike, i përkasin kategorisë paga dhe shtesa.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e Ligjit të buxheti dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

- Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate ndikojnë në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e RVF-ve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që gjatë përgatitjes së buxhetit të merren parasysh kërkesat e Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore dhe Qarkores Buxhetore të MFPT-së, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në kategoritë ekonomike adekuate me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### Çështja A1 - Nënvlërim i detyrimeve kontingjente në PFV

- Gjetja** Sipas nenit 18 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore, në harmoni me LMFPN-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Komuna, në PFV-të për vitin 2025, kishte shpallur detyrime kontingjente në vlerë totale prej 417,273€, nga të cilat 76,843€ i takonin paga dhe mëditje, 109,807€ mallra dhe shërbime, 187,737€ shpenzimet komunale dhe 42,887€ investime kapitale.

Megjithatë, detyrimet kontingjente të paraqitura në PFV nuk ishin të plota dhe të sakta. Nga dy mostra të testuara kemi identifikuar nënvlërim të detyrimeve kontingjente në vlerë prej 355,000€.

Po ashtu, kemi vërejtur se vetëm nga lista e padive për shpronësime prej 99 rasteve, vetëm një rast në vlerë prej 29,577€ ishte prezantuar në shpallje tek PFV, përderisa të tjerat nuk ishin shpallur. Për më tepër, në shumicën e regjistrave sektorialë, rastet ishin evidentuar pa vlerën fillestare të kontestit, duke vështirësuar paraqitjen e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së një regjistri unik për evidentimin e detyrimeve kontingjente, si dhe mos-përfshirjes së të gjitha rasteve në shpalljet e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2025.

- Ndikimi** Prezantimi i pasaktë i detyrimeve kontingjente nuk siguron pasqyrim të drejtë të vlerës së tyre në PFV për palët e interesit. Njëkohësisht, kjo ndikon që komuna të mos jetë në gjendje të parashikojë dhe të bëjë planifikimet e duhura buxhetore, të cilat mund të ndikohen nga lëndët në konteste gjyqësore, pavarësisht trajtimit të tyre me kohë.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e kontrolleve të duhura në azhurnimin me kohë të raportit të detyrimeve kontingjente, si dhe një regjistri unik për evidentimin e të gjitha detyrimeve kontingjente për të mundësuar raportim të plotë të detyrimeve kontingjente në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

**Gjetja** Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Në pesë mostra të testuara, me vlerë totale prej 252,903€, është vërejtur se faturat janë paguar me vonesë përtej afatit ligjor prej 30 ditësh për pagesën e obligimeve. Vonesat ishin nga 73 deri 284 ditë kalendarike.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme.

**Ndikimi** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara apo implikimeve buxhetore për vitin aktual, si dhe kosto financiare si rezultat i ngarkesave shtese në emër të kamatave dhe shërbimeve të përmbarimit.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Mos respektim i kërkesave të dosjeve të tenderit

**Gjetja** Neni 40.13 i Rregullorjes Nr.001/2022 për Prokurimin Publik përcakton që: "Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit."

Në dy procedura të prokurimit, komuna nuk kishte respektuar kërkesat e dosjeve të tenderit:

- Tek procedura "Renovimi i stadionit të qytetit në Gjakovë - konstruksioni i mbulesës dhe ndriçimi i fushës së lojës" me vlerë të kontratës prej 3,424,264€ në dosjen e tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional, ndër të tjera ishte kërkuar:

Kontratat dhe referencat me OE privat, prezantimi i situacioneve të nënshkruara së bashku me transaksionet bankare që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë. Megjithatë, operatori fitues kishte dorëzuar vetëm një deklaratë se për kontratat me klientë privatë nuk praktikon situacione pune.

Në listën e stafit profesional ishte kërkuar një inxhinier të diplomuar, dhe certifikuar për verifikimin e saldimeve me Penetrant Testing, Ultrasonic Testing, Visual Testing, si dëshmi për këtë kishte kërkuar kontratat valide kopje ose parakontratë ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt kopje. Në këtë kërkesë operatori fitues kishte dorëzuar parakontratë jo me inxhinierin si person fizik, por parakontratën e kishte lidhur më subjekt juridik pra me operator ekonomik.

Po ashtu, ishte kërkuar një inxhinier i arkitekturës dhe një inxhinier i gjeodezisë me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Ne vërejtëm se operatori fitues nuk kishte dëshmuar përvojën e kërkuar pesëvjeçare pas diplomimit për arkitektin dhe inxhinierin e gjeodezisë.

Tek lista e pajisjeve komuna kishte kërkuar dy kamionë me kran me kapacitet bartës të kamionit minimum 12t, dhe kapacitet maksimal ngritës të kranit minimum 5t. Ne vërejtëm se për njërin kamion nuk ka dëshmi për kapacitetin maksimal të ngritjes sipas kërkesës.

- Tek procedura "Furnizim me material të shtypur zyrtar" me vlerë të kontratës prej 91,090€, në dosjen e tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional, ndër të tjera ishte kërkuar: OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri vitet e fundit në një vlerë prej jo më pak se 300,000€. Poashtu, që kualifikimet shkollore dhe profesionale të dëshmhohen përmes CV-ve, diplomave dhe kontratave të punës, ndërsa në rast të kontratës mbi vepër të specifikohet titulli i projektit përkatës. Nga operatori fitues këto kërkesa nuk ishin përmbushur. Këto kërkesa komisionet vlerësuese gjatë vlerësimit të tenderëve i kishin konsideruar të përmbushura.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos vlerësimit dhe mosverifikimit të plotë dhe të duhur të dokumentacionit të ofertuesve nga autoriteti kontraktues në raport me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

#### **Ndikimi**

Kontraktimi i operatorëve ekonomik pa i përmbushur kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, i cili mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet.

#### **Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Mosrespektim i dispozitave kontraktuale në ekzekutimin e pagesës**

#### **Gjetja**

Neni 3 i kontratës së lidhur ndërmjet Komunës dhe OJQ -së përcakton se pagesa e mjeteve financiare duhet të realizohet në llogarinë bankare të përfituesit, respektivisht të OJQ-së përfituese, sipas të dhënave të specifikuara në kontratë.

Komuna ka ndarë një subvencion në vlerë prej 13,000€ për OJQ, në përputhje me marrëveshjen kontraktuale në fuqi. Sipas kontratës, pagesa ishte përcaktuar të ekzekutohej në llogarinë bankare zyrtare të OJQ-së përfituese.

Megjithatë, nga ekzaminimi i dokumentacionit financiar dhe urdhërpagesave kemi identifikuar se mjetet nuk janë transferuar në llogarinë bankare të OJQ-së përfituese, siç ishte përcaktuar në kontratë, por në llogarinë bankare të kompanisë kontraktuese të OJQ-së, ndaj së cilës komuna nuk kishte marrëdhënie kontraktuale, duke përbërë devijim nga dispozitat e kontratës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe çertifikimit jo të duhur të pagesës nga zyrtarët përgjegjës.

**Ndikimi** Realizimi i pagesës në llogari tjetër nga ajo e përcaktuar për përfituesin ka ndikuar në cenimin e kontrollit financiar dhe transparencës, duke rritur rrezikun e parregullsive në menaxhimin e mjeteve publike.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e çertifikimit dhe ekzekutimit të pagesave, në mënyrë që pagesat të realizohen vetëm në përputhje me kushtet e marrëveshjes dhe të dhënat bankare të përfituesit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Ndarja e subvencioneve në mungesë të kontratës/ marrëveshjes me përfituesit**

**Gjetja** Sipas nenit 22 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, institucioni (ofruesi i mbështetjes) është i obliguar që të lidhë kontratën me shkrim me përfituesin brenda një afati maksimal prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike. Gjithashtu, sipas Rregullores nr. 3560/2020 për ndarjen e subvencioneve të komunës së Gjakovës, neni 3 subvencionet/transferet pika 2. Subvencionet që i paguhen një personi fizik apo juridik duhet të bazohet në një marrëveshje/kontratë zyrtare mbi formën e subvencionimit.

Komuna kishte ndarë subvencione në vlerë prej 200,000€ për Ndërmarrjen Publike Lokale (NPL), për nevoja të furnizimit me gdhendla druri- Biomasa si dhe 25,000€ për një OJQ, për mbështetjen e projektit “ofrimin e shërbimeve bio-psikosociale për personat me aftësi të kufizuara” pa lidhur paraprakisht kontratë apo marrëveshje me përfituesit e subvencioneve, vetëm me aprovim të Kuvendit Komunal.

Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit të plotë të kërkesave të rregulloreve në fuqi për ndarjen e subvencioneve dhe dobësive në kontrollet e brendshme lidhur me formalizimin e marrëdhënieve me përfituesit.

**Ndikimi** Mungesa e kontratave me përfituesit rrisin rrezikun e parregullsive në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e subvencioneve, si dhe cenojnë ligjshmërinë dhe transparencën e procesit.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë që ndarja e subvencioneve të bëhet vetëm pas lidhjes së kontratave/marrëveshjeve me përfituesit si dhe të forcojë

kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrjen për të garantuar transparencë, ligjshmëri dhe trajtim të barabartë të të gjithë përfituesve të subvencioneve.

## Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A5 - Nënshkrimi i kontratës me vlerë më të madhe se vlera e parashikuar

#### Gjetja

Rregullorja nr. 001/2022 për prokurim publik, përkatësisht neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës përcakton se: Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike. Po ashtu Neni 43 ndërprerja e procedurave të prokurimit paragrafi 43.7. Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK. Tutje, në nenin 8.7 theksohet se personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale.

Komuna me datën 07.11.2025 kishte lidhur kontratë publike kornizë për projektin “Furnizim me dru dhe pelet” në shumë 206.514€. Ne kemi identifikuar se komuna në planin e prokurimit vlerën e parashikuar të kontratës publike e kishte parallogaritur në shumë 162.554€ dhe mbi bazën e kësaj vlere kishte iniciuar edhe procedurën e prokurimit. Vlera e parashikuar e kontratës nuk ishte përcaktuar siç e parasheh rregullativa ligjore mbi bazën e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.

Prandaj si rrjedhojë e saj oferta nga operatori ekonomik ishte shumë më e madhe se sa vlera e parashikuar. Edhe përkundër këtij fakti, komuna nuk e kishte anuluar procedurën e prokurimit edhe pse buxheti i komunës ishte dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar. Vlen të theksohet se Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve (DNDF) ishte nënshkruar me vlerë të parashikuar prej 162,554€.

Komuna kishte ndërrmarrë veprime për të mbuluar diferencën dhe kishte shkurtuar disa projekte të tjera të planifikuara.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i planifikimit jo të duhur të nevojave dhe mos vlerësimit adekuat të çmimeve të tregut gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar, si dhe moszbatimit të kërkesave rregullative lidhur me verifikimin e disponueshmërisë së fondeve.

#### Ndikimi

Nënshkrimi i kontratës me vlera më të mëdha se sa vlera e parashikuar, rritë rrezikun që komuna të hyjë në obligime kontraktuese pa mbulesë financiare, të cilat mund ta ekspozojnë komunën para vështirësive për pagesën e obligimeve.

#### Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj që në rastet e furnizimeve të tilla të përcaktohen sasi të indikative të furnizimeve në mënyrë që vlera e parashikuar e kontratës të jetë e arsyeshme dhe reale, dhe më pas të inicioj procedurat e prokurimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025, ishin 5,934,237€, përderisa ishin shpenzuar 5,448,775€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë totale prej 1,521,967€, të hyra nga gjobat e gjykatës në vlerë 98.295€, si dhe pranimet nga donacionet në vlerë prej 52,931€.

#### Çështja A6 - Dobësi në dhënien e lejeve ndërtimore dhe llogaritjen e sipërfaqëve për ndërtim

##### Gjetja

Neni 21 i Ligjit për ndërtim Nr.04/L-110, paragrafi 1 parasheh “Leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji”. Paragrafi 3 përcakton “Nëse kushtet e parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, organi kompetent brenda 45 ditëve për kategoritë II dhe III e lëshon lejen ndërtimore duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës”.

Gjatë testimit të mostrave për leje ndërtimore, në një rast kemi identifikuar se komuna kishte protokoluar konfirmimin për aplikim të palës për leje ndërtimore në vitin 2023, me ç’rast edhe kishte llogaritur ngarkesat e taksave për palën. Ne kemi vërejtur se komuna brenda afatit të përcaktuar nuk kishte aprovuar apo refuzuar kërkesën për leje sipas kërkesave ligjore. Më tej, e njëjta palë kishte aplikuar për leje ndërtimi bazuar në protokollin e kërkesës së vitit 2023 me ç’rast kishte përfituar sipërfaqe më shumë ndërtimi më rreth 2160 metër katrorë si rezultat i faktit se në 2024 ishte miratuar harta zonale komunale me ç’rast në zonën e dedikuar të ndërtimit ishte rritur koeficienti i ndërtimit.

Llogaritja e tarifës për rregullimin e infrastrukturës nga komuna bazohet kryesisht në dokumentacionin dhe kalkulimet e paraqitura nga aplikuesit në projektet investive. Komuna nuk ka vendosur mekanizma të mjaftueshëm kontrolli dhe verifikimi për të konfirmuar saktësinë e sipërfaqeve dhe parametrave që shërbejnë si bazë për kalkulimin e tarifës. Në dy raste të testuara nga auditimi janë identifikuar dallime në metra katror ndërmjet kalkulimeve të prezantuara nga aplikuesit dhe të dhënave të verifikuara nga auditimi.

Mungesa e procedurave dhe mos funksionimi i kontrolleve të brendshme për verifikimin të sipërfaqeve të prezantuara nga palët aplikues kanë rezultuar me dobësitë e evidentuara,

##### Ndikimi

Mungesa e mekanizmave verifikues rrit rrezikun e kalkulimit jo të saktë të tarifave infrastrukturore, çka mund të ndikojë në: arkëtimin më të ulët ose më të lartë të të hyrave komunale. Poashtu trajtim jo të barabartë të palëve potencialisht dhe konteste administrative apo financiare me investitorët.

##### Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë mekanizma efektivë kontrolli dhe verifikimi të dokumentacionit teknik dhe kalkulimeve të prezantuara nga aplikuesit, duke

siguruar që tarifat infrastrukturore të bazohen në të dhëna të sakta dhe të verifikuara nga zyrtarët përgjegjës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,487.000€, krahasuar me buxhetin fillestar i cili ishte në vlerë 19.298.000€. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës në vlerë 1,486.648€, si dhe nga donacionet me vlerë 158.059€.

### Çështja A7 - Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore

**Gjetja** Neni 102 i Ligjit nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtarëve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 “ Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”. Neni 103 i këtij ligji , paragrafi 1 parasheh “Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren në afat prej një (1) viti nga hyrja në fuqi”. Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.

Nga testimi i 70 mostrave, në nëntë raste u identifikua se kontratat e punës ose aktet e emërimeve të nëpunësve/zyrtarëve komunal në sektorin e shëndetësisë dhe një rast në sektorin e arsimit nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin aktual të pagës bazë dhe koeficientin përkatës.

Megjithëse paga e këtyre punonjësve ishte përlogaritur sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, kontratat e punës/aktet e emërimit nuk pasqyronin formalisht nivelin aktual të pagës dhe koeficientin përkatës.

Vlen të përmendet, që Zyra e Personelit është në proces të finalizimit të nënshkrimit të kontratave të reja.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm tek burimet njerëzore në drejtorinë e shëndetësisë për t’i harmonizuar kontratat me ligjet e reja në fuqi.

**Ndikimi** Megjithëse paga e këtyre punonjësve ishte përlogaritur sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, kontratat e punës/aktet e emërimit nuk pasqyronin formalisht nivelin aktual të pagës dhe koeficientin përkatës.

**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të siguroj se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal të përditësohen dhe harmonizohen sipas kornizës dhe afateve ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere është 1,053,9765€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 1,085,565€ ose 95.88% e buxhetit.

#### Çështja A8 - Mos respektimi i rregulloreve për përbërjen e Komisionit Vlerësues

##### Gjetja

Sipas nenit 8 të Rregullores MF-NR-04/2017, si dhe sipas nenit 17 të Rregullores për Subvencione nr. 3560/2020 të Komunës së Gjakovës, Komisioni Vlerësues duhet të përbëhet nga pesë anëtarë të rregullt dhe një anëtar rezervë, i cili shërben për të siguruar vazhdimësinë e procesit në rastet kur një anëtar ka konflikt interesi.

Në procesin e subvencionimit për "Mekanizëm bujqësor" dhe "Mbështetje financiare për projektet/programet e OJQ-ve në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", Komuna kishte themeluar Komisionin e Vlerësimit të aplikacioneve vetëm me pesë anëtarë, pa përfshirjen e anëtarit rezervë në përbërjen e komisionit vlerësues.

Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit të plotë të kërkesave të rregulloreve në fuqi për ndarjen e subvencioneve dhe dobësive në kontrollet e brendshme lidhur me formalizimin e marrëdhënieve me përfituesit dhe përbërjen e komisioneve të vlerësimit.

##### Ndikimi

Mosrespektimi i përbërjes së Komisionit Vlerësues rrisin rrezikun e parregullsive në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e subvencioneve, si dhe cenon ligjshmërinë dhe transparencën e procesit.

##### Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë që komisionet vlerësuese të themelohen në përputhje të plotë me rregulloret në fuqi, përfshirë caktimin e anëtarit rezervë, si dhe të forcojë kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrjen për të garantuar transparencë, ligjshmëri dhe trajtim të barabartë të të gjithë përfituesve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2025 ishte 15,999,036€, prej tyre ishin shpenzuar 14,742,931€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për rregullimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e ujësjellësit etj.

### Çështja B3 - Pranimi pa komision i mallrave dhe furnizimeve tjera kapitale

**Gjetja** Sipas Rregullores nr 002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 001/2022 për prokurim publik, neni 72A Pranimi i furnizimeve, shërbimeve dhe punëve paragrafi 1. Pranimi i furnizimeve bëhet nga Komisioni për Pranimin e furnizimeve i cili emërohet me Vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ. Komisioni për Pranimin e furnizimeve ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuar, të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblertjen. gjithashtu sipas paragrafit 72A.3. Pranimi i punëve, shërbimeve bëhet nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës i cili ka përgjegjësinë të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së punëve të pranuar, të cilat dokumentohen me raport përfundimtar se janë në përputhshmëri me kontratën dhe specifikimet teknike.

Nga testimi i dy mostrave me vlerë prej 119,814€, për pajime dhe sinjalizim i trafikut rrugor, dhe blerja e pajisjeve për shkollën e mjekësisë, kemi vërejtur se vërejtur se ZKA nuk kishte themeluar komision për pranim të mallrave apo pasurive të blera.

Në të gjitha rastet vetëm projekt menaxherët e këtyre kontratave kishin bërë pranimin e këtyre mallrave.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ZKA nuk kishte marrë vendime për formimin e komisioneve për pranim.

**Ndikimi** Pranimi i mallrave dhe furnizimeve në mungesë të komisioneve të pranimit rritë rrezikun se mallrat apo furnizimet mund të mos pranohen sipas cilësisë, kushteve dhe elementeve tjera të përcaktuara në kontratë.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të siguroj se për çdo furnizim të mallrave, pajisjeve të cilat komuna i blen apo i përvetëson duhet të marre vendime për formimin e komisioneve për pranimin e punëve dhe furnizimeve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C1 - Përdorimi i shpeshtë i Aneks kontratave

**Gjetja** Sipas Rregullores 001/2022 për prokurim publik, neni 13, paragrafi 4 parashikon se "Një kontratë nuk mund të vazhdohet, të përtërihet ose të përcjellët nga një kontratë pasuese pa administrimin e procedurës së re. Megjithatë, brenda një shumë prej 10% të vlerës së kontratës një kontratë për furnizime/shërbime/punë shtesë, të cilat nuk ishin përfshirë, dhe as kryer në kontratën origjinale, por të cilat për arsye të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës, mund të realizohet si kontratë shtesë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Komuna gjatë vitit 2025 kishte lidhur 12 aneks kontrata për punë shtesë në vlerë prej 405,567€. Aneks kontratat kryesisht ishin për asfaltimin e rrugëve, ndërtimin e kanalizimit dhe renovimin e objekteve të ndryshme. Punët shtesë ishin arsyetuar nga menaxherët e kontratave, dhe ishin aprovuar nga ZKA dhe lejohen edhe me ligj. Megjithatë vërehet qartë se kjo ishte bërë dukuri e shpeshtë edhe gjatë këtij viti, dhe shkaktarët kryesor për këtë ishin tek hartimi i dobët i projekteve bazike ku si rezultat i implementimit të tyre pothuajse pjesa dërrmuese e tyre përcillen me kosto shtesë - anekse për tu përmbyllur.

Sipas zyrtarëve të komunës, arsyet e numrit të lartë të aneks kontratave ishin për shkak të dobësive në projektim dhe hartim të projekteve ekzekutive, me ç'rast pa to nuk mund të kompletoheshin projektet, në disa raste ishin kërkesat e komunitetit për zgjatjen e rrugëve dhe asfaltimin e segmenteve të reja, zgjatjen e rrjetit të kanalizimit, etj.

**Ndikimi**

Numri i lartë i aneks kontratave nxjerr në pah mangësitë në planifikimin e tyre rrjedhimisht hartimin e dobët të tyre, duke krijuar kosto shtesë të projekteve aktuale. Po ashtu, punët shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja.

**Rekomandimi C1**

Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha projektet kapitale janë të planifikuara, hartuara dhe të detajuara mirë përpara inicimit të procesit të prokurimit me qëllim të menaxhimit efektiv të fondeve të këtyre projekteve. Po ashtu, duhet të sigurojë se aneks kontrata përdoret në rastet e jashtëzakonshme dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 110,373,055€, pasurive jokapitale është 1,654,272€, si dhe e stoqeve 196,947€.

#### Çështja B4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

**Gjetja** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Pasuritë e regjistruara në regjistrin kontabël të pasurive në klasën investime në vijim datojnë nga viti 2015, vlera e pasurive të regjistruara si investime në vijim me datën 31.12.2025 arrin në vlerë 60,177,503€.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 480 transaksione për pasuri në vlerë 11,925,572€ në klasën e pasurive si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2011-2019, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara.

Përderisa, prej totalit të pasurive si investime në vijim gjatë vitit 2025, janë mbyllur dhe janë regjistruara në klasat përkatëse të pasuri gjithsej 3,803,969€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

**Ndikimi** Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduar, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Mos regjistrimi i drejtë i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive jofinanciare të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e mbivlerësuar.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduar, dhe regjistrimin e pasurive në përdorim.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

##### Çështja A9 - Moszbatim i kërkesave ligjore për inventarizimin e pasurive

**Gjetja** Paragrafi 3, i nenit 18 (Inventarizimi i pasurisë jo-financiare), si dhe neni 17, i Rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo-financiare në organizatat buxhetore, përcaktojnë obligimin e organizatave buxhetore për themelimin e komisionit për inventarizim dhe kryerjen e inventarizimit të pasurisë jo-financiare së paku një herë në vit, me qëllim të verifikimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të saj.

Komuna gjatë vitit 2025 nuk kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive, ndërsa i njëjti, edhe pse u themelua me vonesë në janar 2026,

nuk kishte kryer inventarizimin e plotë dhe nuk kishte hartuar raportin përkatës, përveç identifikimit të pasurive jashtë përdorimit, në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit adekuat dhe dobësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes nga menaxhmenti përgjegjës.

**Ndikimi**

Mos zbatimi i kërkesave për themelimin e komisionit dhe kryerjen e inventarizimit vjetor ka ndikuar në mungesën e një pasqyre të saktë dhe të besueshme të gjendjes së pasurisë jo-financiare, duke rritur rrezikun për pasaktësi në regjistrat kontabël, dobësim të kontrollit mbi pasurinë publike, si dhe mundësi për keqmenaxhim të saj.

**Rekomandimi A9**

Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë vendimet në kohën e duhur për zbatimin e plotë, të rregullt dhe në kohë të kërkesave të Rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo-financiare, duke themeluar me kohë komisionin për inventarizim e pasurisë, si dhe të forcohen kontrollet që komisioni të kryejë dhe të përgatisë raportin e inventarizimit në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.6 Të arkëtueshmet

Komuna e Gjakovës ka paraqitur kërkesa në PFV për Llogari të arkëtueshme për vitin 2025 në vlerë prej 16,259.339 €. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë prej 14.088.883€, për dhënien e pronave, tokave dhe tregjeve në shfrytëzim 366,485€ dhe tatimit në biznes 1,631,267€ si dhe taksave për leje ndërtimi prej 200.857€. Rritja e të arkëtueshmeve mund të shihet vazhdimisht gjatë viteve krahasuar me vitin 2024. Në vitin 2025 llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 1,899,901€ ose 13%.

#### Çështja B5 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

<b>Gjetja</b>	<p>Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 04.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ligj i lartë shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përmbartimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.</p> <p>Megjithatë, procedura përmbartimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përmbartimit ndaj Vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullorës për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme kanë rritje, krahasuar me vitin 2024. Në fund të vitit 2025 të arkëtueshmet ishin rritur për 1,899,900€, kjo vërehet tek ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë dhe taksa në firmë), ku borxhi ka vlerën prej 4,296,930€. Rritja më e madhe e të arkëtueshmeve është në tatimin në pronë, krahasuar me vitin paraprak këtë vit obligimet ndaj tatimit në pronë janë rritur në vlerë 1,442,469€ apo në masën prej 11%. Komuna kishte bërë përpjekje për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, përmes letërkujtesave si dhe vërejtjeve përfundimtare ndaj debitorëve, mirëpo këto masa nuk ishin mjaft efektive dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është negativ, për faktin e mos dërgimit të borxhlinjëve tek përmbartuesit.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.</p>
<b>Rekomandimi B5</b>	<p>Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbartuesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.3.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Gjakovës ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm, kjo njësi kishte operuar me vetëm dy auditor. Komiteti i auditimit është i themeluar dhe përbëhet nga tre anëtar i cili ka mbajtur vetëm dy takime në vitin 2025. NJAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm ku kishte përfunduar pesë auditime të rregullta aq sa ishin planifikuar me planin vjetor dhe një auditim me kërkesë. Në këto raporte janë dhënë shtatëmbledhete rekomandime.

#### Çështja A10 - Mosfunksionimi i duhur i Komitetit të Auditimit dhe dështimi në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

**Gjetja** Neni 8 i Udhëzimit Administrativ të MF-nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit (KA) përcakton që takimet e komitetit të Auditimit mbahen së paku katër herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i KA. Në takime diskutohen çështjet siç janë përcaktuar me këtë udhëzim dhe mbahen procesverbale.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2025 kishte pësuar ndryshime në përbërjen e tij për shkak të tërheqjes së kryesuesit dhe njërit anëtar. Kështu që në shtator të këtij viti, me vendim të Kryetarit të Komunës është rithemeluar Komiteti i Auditimit.

Deri në fund të vitit 2025 KA kishte mbajtur vetëm dy takime, që sipas procesverbaleve të mbajtura dëshmohej se janë miratuar plani vjetor dhe planin strategjik i NJAB, por nga pesë raportet finale të kësaj njësie, asnjë nuk kanë arritur të shqyrtojnë gjer në fund të vitit.

Ndryshimet në përbërjen e Komitetit të Auditimit brenda vitit, si dhe periudha e zgjedhjeve lokale dhe parlamentare kanë qenë shkak që KA mos të jetë plotësisht funksional dhe t'i përmbush kërkesat në pajtim me ligjin.

**Ndikimi** Ndryshimet në përbërjen e Komitetit të Auditimit brenda vitit, si dhe periudha e zgjedhjeve lokale dhe parlamentare kanë qenë shkak që KA mos të jetë plotësisht funksional dhe t'i përmbush kërkesat në pajtim me ligjin.

**Rekomandimi A10** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e duhura që Komiteti i Auditimit të jetë funksional, si dhe përbërja e tij të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NJAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështjet e identifikuar janë si në vijim:

#### Çështja 1

#### **Gabimet e identifikuar gjatë rishikimit të PVF-ve për Komunën e Gjakovës**

#### Gjetja

Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - burimet e fondeve pranimet

Fondi burimor- Granti qeveritar pagesat janë prezantuar në vlerë 36,137,000€, duhej të prezantohen në vlerë 35,915,753€, pagesat nga fondi burimor - të hyrat vetanake janë prezantuar në vlerë 7,080,000€, duhej të prezantohen në vlerë 6,094,022€. Fondi burimor- Grantët e pacaktuara të donatorëve janë prezantuar pagesa në vlerë 158,000€ duhej të prezantohen pagesa në vlerë 48,989€.

Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - burimet e fondeve pagesat-

Shënimi Nr. 2 Kategoria ekonomike-pagat dhe shtesat, shpenzimet janë prezantuar në vlerë 20,790,000€, duhej të prezantohen në vlerë 20,786,943€.

Shënimi Nr. 3 Kategoria ekonomike-mallra dhe shërbime janë prezantuar shpenzimet në vlerë 4,892,000€, duhej të prezantohen në vlerë 4,707,710€;

Shënimi Nr. 4 Kategoria ekonomike-Komunali janë prezantuar shpenzime në vlerë 949,000€ duhej të prezantohen në vlerë 947,784€;

Shënimi Nr. 5 Kategoria ekonomike-Subvencione dhe Transfere janë prezantuar shpenzime në vlerë 1,145,000€, duhej të prezantohen në vlerë 1,001,808€; dhe

Shënimi Nr. 6 Kategoria ekonomike-Investime Kapitale janë prezantuar shpenzime në vlerë 15,599,000€ duhej të prezantohen shpenzime në vlerë 14,614,519€.

Në pasqyrën burimet e fondeve pranimet dhe pagesat, nga burimet e fondeve dhe pagesat për kategori ekonomike është prezantuar buxheti final në SIMFK, ne total 43,374,595€ duhej të prezantohen shpenzimet e ndodhura në vitin 2025, në vlerë 42,058,764€.

Sipas sqarimeve të pranuar nga ZKF, ky keqprezantim ka ndodhur si rezultat i një lëshimi teknik gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, ku në nivel të kategorive ekonomike janë vendosur vlerat e buxhetuara në vend të vlerave të realizuara.

**Neni 14- Raporti i ekzekutimit të buxhetit****Pjesa hyrja e parasë së gatshme**

Të Hyrat tatimore e planit fillestar në raport me planin final është zvogëluar për 439,000€.

Të Hyrat jo tatimore e planit final në raport me planin fillestar është zvogëluar për 49,000€.

**Shënimet shpjeguese**

Shënimi Nr. 12 Kategoria të Tjera-janë prezantuar kthimi i depozitave në vlerë 10,000€, duhej të prezantohen pranimit i depozitave nga shpronësimet në vlerë 223,339€.

Shënimet shpjeguese për kategoritë, paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, Subvencione dhe transfere dhe investime kapitale në kolonën buxheti final është prezantuar shpenzimi i vitit 2025 jo buxheti final, duhej të prezantohet buxheti final për secilën kategori ekonomike.

Shënimi Nr. 7 Të tjera- duhej të prezantohen kthimi i depozitave për shpronësime në vlerë 9,893€.

Shënimi Nr. 12 Kategoria të Tjera- janë prezantuar kthimi i depozitave në vlerë 10,000€, duhej të prezantohen pranimit i depozitave nga shpronësimet në vlerë 223,339€.

**Veprimi i kërkuar**

Gjatë rishikimit të PVF-ve, auditori ka kërkuar nga Komuna që të korrigojë pasqyrat vjetore financiare duke plotësuar dhe prezantuar në mënyrë të saktë të gjithë zërat financiarë, në përputhje me kërkesat e Rregullores MF Nr. 01/2017.

**Rezultati**

Komuna ka ndërmarrë veprime dhe ka korrigjuar zërat e identifikuar në PVF, duke i ridorëzuar ato në Thesar më 02.02.2026, me ç'rast janë adresuar mangësitë e evidentuara dhe është siguruar prezantim më i plotë dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

## 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>40,584,369</b>	<b>43,374,595</b>	<b>42,058,764</b>	<b>41,635,481</b>	<b>37,887,249</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	34,650,132	36,136,780	35,915,753	33,241,582	29,288,858
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,145,519	1,010,155	1,814,808	2,846,991
Të hyrat vetanake	5,934,237	5,934,237	5,083,868	6,228,203	5,163,647
Donacionet vendore	0	46,772	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	111,286	48,989	350,888	587,753

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,790,226€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, si dhe donacioneve. Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 42,058,764€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2025, komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ju kanë ekzekutuar rreth 2,700,991€ nga kategori të ndryshme ekonomike.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>40,584,369</b>	<b>43,374,595</b>	<b>42,058,764</b>	<b>41,635,481</b>	<b>37,887,249</b>
Pagat dhe mëditjet	19,297,938	20,790,412	20,786,943	20,237,271	18,295,920
Mallrat dhe shërbimet	4,670,000	4,891,687	4,707,710	4,836,558	4,136,946
Komunalitë	788,500	948,500	947,784	784,057	687,330
Subvencionet dhe transferet	1,085,000	1,144,959	1,001,808	1,010,565	695,219
Investimet Kapitale	14,742,931	15,599,036	14,614,520	14,767,031	14,071,834

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,492,474€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës me vlerë 1,486,648€, si dhe nga donacionet me vlerë 5,826€.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 221,687€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024, për 195,000€, si dhe rritje nga donacionet për 26,687€.

Buxheti final për komunalitë ishte rritur për 160,000€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2024 me vlerë 160,000€.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 59,959€, nga kjo vlerë 57,000€, ishte rritje nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024, si dhe nga donacionet 2,959€.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 856,105€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2024 për 733,519,30€, dhe rritje nga donacionet për 122,586€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025, ishin 5,934,237€, përderisa ishin realizuar 5,448,775€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë totale prej 1,521,967€, të hyra nga gjobat e gjykatës në vlerë 98.295€, si dhe pranimet nga donacionet në vlerë prej 52,931€.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,934,237</b>	<b>5,934,237</b>	<b>5,448,775</b>	<b>5,844,817</b>	<b>5,797,084</b>
Të hyrat tatimore	2,865,183	2,865,183	2,428,946	2,308,540	2,742,878
Të hyrat jo tatimore	3,069,054	3,069,054	3,019,818	3,536,069	3,054,205
Të hyrat tjera	0	0	11	208	

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 ka rezultuar me 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, shtatë rekomandime janë zbatuar dhe pesë rekomandime nuk janë zbatuar ende, dhe një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezentimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme në PFV.		I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të analizojë shkaqet e aplikimit jo të drejtë të tarifës për infrastrukturë dhe rritje të densitetit, dhe menjëherë të marrë masa korigjuese në mënyrë që të hyrat nga kjo tarifë të jenë të plota dhe të sakta.		I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa specifikuar qartë me kontratë, si dhe asnjë pagesë të mos çertifikohet jashtë paramasës së kontratave.		I zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë përmes njërive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.		I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se për çdo furnizim të mallrave, pajisjeve të cilat komuna i blen apo i përvetëson duhet të themeloj komision konformë rregullores 02/2013, në mënyrë që të ofrohet siguri se furnizimet e pranuar janë konformë kushteve të kontratës.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara, dhe të mos paguhen punët jashtë paramasës së kontratës.		I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigorozë në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.		I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha projektet kapitale janë të planifikuara, hartuara dhe të detajuara mirë përpara inicimit të procesit të prokurimit me qëllim të menaxhimit efektiv të fondeve të këtyre projekteve. Po ashtu, duhet të sigurojë se aneks kontrata përdoret në rastet e jashtëzakonshme dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e prokurimit publik.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar

10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara, dhe regjistrimin e pasurive në përdorim.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se raportimi (6) mujore në kuvendit komunal të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.		I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbauesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbauese.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fidane Shala Haxhiu, Anëtare e ekipit



Fejzullah Fejza, Anëtar i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Nuk pajtohem me kualifikimin e raportit për shkak të keqklasifikimit si rrjedhojë e kontratës kolektive, kontratë e lidhur nga Niveli Qendror.	E gjetura qëndron, përmbajtja e komentit është pjesë e prezantuar në raportin e auditimit.

Republika e Kosovës - Republika Kosovë - Republic of Kosovo  
 Komuna e Gjakovës - Opština Gjakovica - Municipality of Gjakovë

ARKIVA DALËSE  
 IZLAZNE ARHIVE  
 OUTPUT ARCHIVES

Numri/Idri/No: 01-0520/1-28760  
 Data/Datum/Date: 19.06.2026

Gjakovë - Gjakovica - Gjakovë



Republika e Kosovës - Republika Kosovë - Republic of Kosovo  
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRASHUR/QUESTIONED: 19.06.2026

Org. Unit	Sh. Klasifikim/Classification No.	N. Pajtim/No. Pages	F. i Enjësive/Of. Stranica
04	47	1083	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në raport, nuk pajtohem me kualifikimin e raportit për shkak të keq klasifikimit si rrjedhojë e kontratës kolektive, kontratë e lidhur nga Niveli Qendror.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ardian Gjini

Zyrtari Kryesor Administrativ

Data: 19.06.2026,

Gjakovë,



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.